

# Mbaje mend

- Antibiotikët nuk ndikojnë në rast të ftohjes apo gripit
- Tregoju i përgjegjshëm gjatë pirjes së antibiotikëve dhe piji vetëm me rekomandim nga mjeku
- Ruajtja e efikasitetit të antibiotikëve është përgjegjësi e të gjithëve



МИНИСТЕРСТВО ЗА ЗДРАВСТВО  
РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА



Институт  
за јавно здравје



Институт за  
микробиологија и  
паразитологија,  
Медицински факултет,  
Скопје



ФЗОМ  
Фонд за здравствено  
осигурување на  
Македонија

Центар за регионални истражувања и соработка

Nëse keni nevojë të pranoni antibiotikë, tregojuni të ndërgjegjshëm

Kur merrni një recetë për antibiotik, doemos duhet t'i ndiqni udhëzimet e mjekut me qëllim që të zvogëloni rrezikun e zhvillimit të bakterieve rezistente.

Nëse nuk i ndiqni udhëzimet, për shembull, nëse ju zvogëloni kohëzgjatjen e trajtimit, në qoftë se ju merrni një dozë më të vogël, ose nuk pranoni antibiotikun në një interval kohor të caktuar sipas këshillës së mjekut tuaj, bakteriet mund të bëhen rezistente ndaj antibiotikëve.

Bakteriet rezistente mund të mbijetojnë gjatë kohë në organizmin tuaj, si dhe të përcillen tek të tjerët. Në këtë mënyrë ju mund të rrezikoni veten tuaj dhe të tjerët – domethënë, herën tjetër që do keni nevojë të pranoni antibiotikë, ato nuk do kenë efekt.

- Ndiqni këshillën e mjekut për atë se KUR dhe SI të pranosh antibiotikët
- Mos përdorni antibiotikët e mbetur nga trajtimi i ndonjë infeksioni të mëparshëm
- Pyet mjekun ose farmacistin tend si të veprosh me antibiotikët të papërdorura

Më shumë informacion në lidhje me përdorimin e antibiotikëve racionalana:

<http://antibiotic.ecdc.europa.eu>  
<http://studiorum.org.mk>  
<http://zdravstvo.gov.mk>  
<http://fzo.org.mk>

## FUSHATA PËR PËRDORIM RACIONAL TË ANTIBIOTIKËVE



## Ndërgjegjësi për përdorimin e antibiotikëve: Të ruajmë efikasitetin!

Ky aktivitet është mbështetur nga Zyra Botërore e Organizatës Shëndetësore Rajonale për Evropën, me financim nga Qeveria e Belgjikës.

Antibiotiket nuk jan kamele.  
Kur përdoren në mënyre joracionale,  
kamelet krijojnë karies, a  
antibiotikët rezistencë

Pranoni antibiotikë  
vetëm në rast  
nevoje

Shumë dekada antibiotikët shërojnë infeksionet që rrezikojnë jetën e njeriut. Por në vitet e fundit, përdorimi i padrejtë i tyre ka shkaktuar zhvillimin dhe përhapjen e bakterieve që janë rezistente ndaj antibiotikëve.

Kur njerëzit fitojnë një infektion të cilin e shkakton një bakterie rezistente, antibiotikët nuk janë efektiv në trajtimin e infeksionit dhe sëmundja mund të zgjasë për një kohë më të gjatë ose të kalojë në një formë më serioze.

Zhvillimi i rezistencës ndaj antibiotikëve është një problem serioz për shëndetin publik, sepse bakteriet rezistente mund të përhapen në komunitet.

- Ruajtja e efikasitetit të antibiotikëve është përgjegjësi e të gjithëve
- Përdorimi me përgjegjësi i antibiotikëve mund të ndalojë bakteriet rezistente
- Kufizimi i bakterieve rezistente do të ruajë efikasitetin e antibiotikëve për brezat e ardhshëm

Antibiotikët nuk jan ushqim që të zgjidhet pa konsultuar mjekun.  
Cdo përdorje e paduhur e zvogëlon efikasitetin e tyre

Antibiotikët duhet të përdoren vetëm në rast nevoje, sepse përdorimi i tepruar do të shkaktojë rezistencën e tyre.

Përdorimi i antibiotikëve kur nuk keni nevojë për to nuk do t'ju ndihmojë. Për shembull, antibiotikët nuk janë efikas për infeksionet e shkaktuara nga viruset siç është ftohja apo gripi. Do ishte normale që sistemi juaj imunitar të jetë në gjendje të luftojë infeksionet e thjeshta. Marrja e antibiotikëve nuk do t'ndihmojë shërimin tuaj ose të parandalojë përhapjen e virusit te të tjerët.

Vetëm mjeku mund të përcaktojë diagnozë të saktë dhe të vendosë nëse gjendja juaj ka nevojë për trajtim me antibiotikë.

- Mos merrni antibiotikë pa reçetë nga mjeku.
- Nëse gjendja juaj nuk përmirësohet ose përkeqësohet gjatë një periudhe kohore, kontaktoni mjekun tuaj, sepse mund të duhet të rishikoheni përsëri.



ANTIBIOTIKËT  
NUK JAN USHQIM

**JENI FTOHUR? KENI GRIP?  
PUSHONI DHE MJEKOHUNI,  
POR PA ANTIBIOTIKË!**

Nëse jeni ftohur apo keni grip dhe mjekun juaj vendosë se antibiotikët nuk ju duhen, siguroni një mënyrë të ndryshme:

1. Pushoni;
2. Merni më shumë lëngje që të mos dehidroni;
3. Pyetni mjekun tuaj për tjetër trajtim simptomatik të hundës së zënë, dhimbjes në fyt, kollës, etj...

Nëse gjendja juaj nuk përmirësohet apo përkeqësohet gjatë periudhës kohore të përcaktuar nga mjeku juaj, kontaktoni me mjekun juaj sepse mbase do keni nevojë të kontrolloheni sërish.